

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut



I N F O R M A C I O N

**për zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në
Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut**

dhjetor, 2024

PËRMBAJTJA:

1. HYRJE	3
2. KUADRI NDËRKOMBËTAR PËR PRAKTIKËN PROFESIONALE TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM	3
3. QËLLIMI KRYESOR I AUDITIMIT TË BRENDSHËM	3
4. LËNDA E PUNËS SË DREJTORISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM	3
5. LLOJE TË AKTIVITETEVE TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM	5
6. UDHËHEQJE ME DREJTORINË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM	5
7. KRYERJA E PROCESIT TË PLANIFIKIMIT DHE TË KRYERJES SË AUDITIMIT	5
8. KONTROLLI I CILËSISË I FUNKSIONIMIT TË DREJTORISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM	8
9. NJOFTIM PËR GUVERNATORIN, KOMISIONIN E AUDITIMIT DHE KËSHILLIN E BANKA POPULLORE	8

1. HYRJE

Funksioni auditim i brendshëm i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore) kryhet nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm (në tekstin e mëtejshëm: DAB). Në këtë informacion përshkruhet kuadri ndërkombëtar për praktikën profesionale të auditorëve të brendshëm, qëllimi kryesor i auditimit të brendshëm, lënda e punës së DAB-it, llojet e aktiviteteve të auditimit të brendshëm, udhëheqja me DAB-in, realizimin e proceseve të planifikimit dhe kryerjes së auditimit të brendshëm, kontrollin e cilësisë së punës së DAB-it dhe mënyrën e raportimit të guvernatori, Komiteti i Auditimit dhe Këshilli i Bankës Popullore.

2. KUADRI NDËRKOMBËTAR PËR PRAKTIKËN PROFESIONALE TË AUDITORËVE TË BRENDSHËM

DAB funksionon në pajtim me Kornizën Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm të Institutit të Audituesve të Brendshëm në Florida, ShBA.

Elementet e detyrueshme të Kornizës Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Audituesve të Brendshëm janë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm (në tekstin e mëtejshëm: Standardet dhe Kërkesat tematike (në tekstin e mëtejshëm: Kërkesat). Elementë shtesë të Kornizës Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Audituesve të Brendshëm janë Udhëzimet Ndërkombëtare, të cilat përmbajnë këshilla më të detajuara dhe praktikatat më të mira për kryerjen e aktiviteteve të auditimit të brendshëm.

3. QËLLIMI BAZË I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Objektivi kryesor i auditimit të brendshëm është të mbështesë Bankën Popullore në krijimin dhe ruajtjen e vlerave të institucionit, duke u ofruar anëtarëve të Këshillit të Bankës Popullore dhe menaxhmentit strategjik siguri, këshillim, njohuri dhe vlerësime të pavarura dhe objekte të bazuara në rrezik.

Auditimi i brendshëm kontribuon në:

- arritjen e suksesshme e qëllimeve strategjike;
- përmirësimin e qeverisjes së korporatës, menaxhimit të rrezikut dhe proceseve të kontrollit të brendshëm;
- forcimin e procesit të vendimmarrjes dhe mbikëqyrjes;
- forcimin e reputacionit dhe besueshmërisë me palët e interesuara;
- realizimin e interesit publik në Bankën Popullore.

4. LËNDA E PUNËS SË DAB-it

DAB-i i vlerëson dhe kontribuon për përmirësimin e procesit të menaxhimit të rrezikut, kontrolleve të brendshme dhe procesit të qeverisjes, nëpërmjet zbatimit të qasjes së bazuar në rrezik.

Procesi i menaxhimit me rreziqet

DAB-i vlerëson efektivitetin e procesit të menaxhimit të rrezikut dhe kontribuon në përmirësimin e tij. Kështu, DAB-i vlerëson nëse:

- synimet organizative mbështesin dhe janë në pajtim me objektivat strategjike;
- janë identifikuar dhe vlerësuar rreziqe të rëndësishme;
- janë ndërmarrë veprimet e duhura për të ballafaquar rreziqet brenda niveleve të pranueshme të rrezikut (oreksi i rrezikut);
- me kohë janë ofruar informatat përkatëse për rreziqet, të cilat do t'u mundësojnë punonjësve, menaxhmentit dhe Këshillit të Bankës Popullore t'i kryejnë përgjegjësitë e tyre.

Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve operacionale në Bankën Popullore bëhen brenda çdo njësie organizative, në pajtim me aktet e brendshme në fuqi.

Kontrolla të brendshme

DAB-i vlerëson përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në Bankën Popullore dhe kontribuon në përmirësimin e vazhdueshëm të tij. Kështu, në përgjigje të rreziqeve brenda procesit të menaxhimit, proceseve të punës, projekteve dhe sistemeve të informacionit, i vlerëson si në vijim:

- përmbushjen e qëllimeve strategjike;
- informacionin financiar dhe operacional, nga këndvështrimi i besueshmërisë, vlefshmërisë dhe integritetit. Metodatat e matjes, analizës, klasifikimit dhe raportimit janë të sigurta (konfidencialiteti, integriteti dhe disponueshmëria);
- operacionet dhe programet kryhen në mënyrë efektive, efikase, etike dhe në pajtueshmëri, burimet dhe mjetet prokurohen ekonomikisht, përdoren në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme dhe mbrohen në mënyrë adekuate;
- proceset dhe sistemet e krijuara mundësojnë respektimin e politikave, procedurave, kontratave dhe rregulloreve, të cilat mund të ndikojnë dukshëm në Bankën Popullore.

Procesi i vlerësimit të menaxhimit të organizatës

DAB-i vlerëson procesin e menaxhimit të Bankës Popullore dhe jep rekomandimet e duhura për përmirësimin e tij, nga këndvështrimi i:

- procesit të marrjes së vendimeve strategjike dhe operacionale;
- mbikëqyrjes së procesit të menaxhimit dhe kontrollit të rrezikut;
- promovimit të etikës dhe vlerave të duhura brenda Bankës Popullore;
- sigurimit të menaxhimit efektiv të operacioneve të njësive organizative;
- aktiviteteve të menaxherëve, drejtorëve, menaxhmentit, punonjësve dhe operatorëve të jashtëm ekonomik ose palëve të tjera përkatëse, dhe nëse ato janë në pajtim me politikat dhe procedurat e Bankës Popullore dhe rregulloret dhe standardet e qeverisjes së zbatueshme;
- ofrimit të informatave lidhur me rreziqet dhe kontrollet për personat kompetentë dhe njësitë organizative në Bankën Popullore; dhe
- koordinimit të aktiviteteve dhe transferimin e informacionit ndërmjet Këshillit të

Bankës Popullore, auditimit të jashtëm dhe të brendshëm, dhe personave përgjegjës të njësive organizative.

5. LLOJI I AKTIVITETEVE TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

DAB-i kryen aktivitete përmes të cilave jep siguri dhe këshilla. Auditorët e brendshëm mund të marrin pjesë në aktivitetet e grupeve ose organeve të punës në rolin e konsulentëve, vëzhguesve ose përfaqësuesve.

DAB-i , nga aspekti i planifikimit kryen auditime të rregullta ose të jashtëzakonshme dhe nga aspekti i subjektit të auditimit mund të kryejë auditime operacionale, financiare, të harmonizimit, auditime të sistemit të informacionit, auditime të integruara, auditime projektsh dhe auditime të zbatimit të rekomandimet e dhëna (përcjellja) dhe auditimi mjeko-ligjor.

6. UDHËHEQJA ME DAB-in

Revizori kryesor i inkurajon revizorët e brendshëm që të:

- punojë në pajtueshmëri me Standardet dhe Kërkesat, duke përfshirë parimet etike dhe profesionale për: integritetin, objektivitetin, kompetencën, kujdesin e duhur profesional dhe konfidencialitetin;
- kuptojnë, respektojnë, përmbushin dhe kontribuojnë në zbatimin e rregulloreve dhe parimeve etike të Bankës Popullore, dhe në të njëjtën kohë të kenë aftësinë për të njohur sjelljen që është në kundërshtim me ato pritje;
- nxisin dhe promovojnë kulturën e etikës në Bankën Popullore;
- raportojnë sjellje që bien ndesh me parimet etike të rregulluara me Kodin e Etikës të Bankës Popullore.

7. KRYERJA E PROCESIT TË PLANIFIKIMIT DHE TË KRYERJES SË AUDITIMIT

Hartimi i programeve të punës dhe planeve të auditimit për DAB-in

DAB-i përgatit një program pune afatmesëm dhe vjetor, në të cilin planifikohen aktivitetet e auditimit të DAB-it.

Programi afatmesëm përgatitet për tre vjet dhe përditësohet çdo vit.

Programi vjetor i punës përgatitet në pajtim me programin afatmesëm të punës dhe ka këtë strukturë:

- plan për kryerjen e auditimeve të rregullta;
- resurse për kryerjen e auditimeve të jashtëzakonshme;
- aktivitetet të tjera të rregullta të DAB-it; dhe
- programë për sigurimin e kualitetit dhe përmirësimin e punës së DAB-it.

Programet afatmesme dhe vjetore të punës së DAB-it i dorëzohen Këshillit të Bankës Popullore, jo më vonë se fundi i janarit të vitit aktual. Programi afatmesëm i punës përcakton strategjinë për zhvillimin e funksionit të auditimit të brendshëm, si dhe lëndën për auditimin e të gjitha proceseve të rëndësishme në periudhë tre vjeçare, përmes vendosjes efektive dhe efikase të burimeve njerëzore dhe të tjera.

Audituesi kryesor i brendshëm zhvillon Plan auditimi të bazuar në rrezik, të cilin ai e rishikon nëse ndodhin ndryshime në operacionet e biznesit, rreziqet, proceset, programet, sistemet dhe kontrollet dhe ia raporton këtë guvernatorit të Bankës Popullore.

Programi afatmesëm dhe ai vjetor për kryerjen e auditimeve të rregullta janë përgatitur në bazë të Metodologjisë për vlerësimin e përgjithshëm të rrezikut. Kjo metodologji identifikon, analizon, vlerëson dhe rendit kategoritë dhe faktorët e rrezikut që mund të ndikojnë në veprimtarinë e Bankës Popullore, si dhe njohuri të tjera aktuale në lidhje me ndryshimet e pritshme, proceset e reja të punës, projektet e planifikuara dhe të ngjashme.

Realizimi i auditimit

Auditorët e brendshëm kryejnë auditime në pajtim me Politikën dhe Rregullat e Punës së DAB-it të miratuara nga Këshilli i Bankës Popullore, Udhëzimet operative dhe procedurat e shkruara të DAB-it. Audituesi kryesor i brendshëm ka përgjegjësi të plotë për kryerjen e mbikëqyrjes mbi auditimin e kryer.

Raporti i auditimit paraqet gjetjet, në bazë të të cilave vlerësohet niveli i rrezikut të mundshëm, repsektivisht nivele të ulëta, të moderuara, të mesme dhe të larta, si dhe rekomandime për reduktimin e rreziqeve në nivel të pranueshëm.

Të dhënat e paraqitura në raportin e auditimit duhet të jenë të sakta, objektive, të qarta, koncize, konstruktive, të plota dhe në kohë.

Bazuar në gjetjet dhe vlerësimet e niveleve të rrezikut, jepet opinion i përshtatshmërisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili vlerësohet si: i mirë, i kënaqshëm, pjesërisht i kënaqshëm dhe i pakënaqshëm.

Raporti i auditimit i dorëzohet:

- guvernatorit;
- menaxherit kompetent strategjik/sectorial të subjektit të audituar; dhe
- personit përgjegjës në subjektin e audituar.

Audituesi kryesor i brendshëm vendos dhe zbaton metodë për mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve të bëra në raportet e auditimit.

8. KONTROLLI I CILËSISË I FUNKSIONIMIT TË DAB-it

Programi për sigurimin e kualitetit dhe avancimin e punës së DAB-it

Audituesi kryesor i brendshëm përgatit dhe siguron zbatimin e Programit për

sigurimin e kualitetit dhe avancimit e punës së DAB-it. Programi mund të përfshijë pajtueshmërinë me rregulloret përkatëse për auditimin e brendshëm. Audituesi kryesor i brendshëm, sipas nevojës, mund të rishikojë Programin e kontrollit të cilësisë dhe përmirësimit të performancës dhe të zbatojë aktivitetet e duhura të kontrollit.

Vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm i Programit për sigurimin e kualitetit dhe avancimin e punës së DAB-it

Programi për sigurimin e kualitetit dhe avancimin e punës së DAB-it përfshin vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm.

Vlerësimi i brendshëm përfshin:

- mbikëqyrjen e vazhdueshme të funksionimit të auditimit të brendshëm;
- vetëvlerësime të brendshme periodike nga DAB-i ose vlerësime nga persona të tjerë të kualifikuar nga Banka Popullore, me njohuri të duhura të auditimit të brendshëm, i emëruar nga guvernatori i Bankës Popullore.

Vetëvlerësimi i brendshëm periodik kryhet të paktën një herë në vit, duke përcaktuar shtrirjen e duhur.

Vlerësimi i jashtëm vlerëson elementët e mëposhtëm:

- funksionimin e auditimit të brendshëm në pajtim me Standardet dhe Kërkesat;
- mjetet dhe teknikat e auditimit, si dhe kompetencat profesionale të punonjësve të DAB-it; dhe
- aftësinë e DAB-it për të kontribuar në përmirësimin e operacioneve të Bankës Popullore.

Vlerësimet e jashtme kryhen nga ekipi i pavarur i të huajve me nivel të përshtatshëm kompetence në fushën e auditimit të brendshëm të paktën çdo pesë vjet, të paktën njëri prej të cilëve duhet të zotërojë certifikatë të vlefshme për një auditor të brendshëm të certifikuar nga Instituti i Audituesve të Brendshëm.

Si alternativë ndaj vlerësimit të jashtëm është vetë vlerësimi i kryer nga audituesi kryesor i brendshëm, i konfirmuar nga ekip i pavarur ekspertësh të jashtëm me të njëjtat kompetenca të listuara më sipër.

Vlerësimi i fundit i jashtëm është kryer në vitin 2021, nga ekspertë të Bankës Qendrore të Holandës, me çka është vlerësuar se puna e DAB-it është "në përgjithësi në pajtueshmëri"¹ me Standardet dhe Kodin e Etikës.

9. NJOFTIMI I GUVERNATORIT, KOMISIONIT TË AUDITIMIT DHE KËSHILLIT TË BANKËS POPULLORE

Auditimi i brendshëm, për punën e tij nga aspekti funksional, respektivisht nga

¹ Ekzistojnë tre nivele të pajtueshmërisë: pajtueshmëri e përgjithshme, pajtueshmëri e pjesshme dhe mospajtueshmëri.

aspekti i mbikëqyrjes së efikasitetit dhe efektivitetit të punës së tij, i përgjigjet drejtpërdrejt Këshillit të Bankës Popullore, dhe nga aspekti administrativ, gjegjësisht nga aspekti i veprimtarisë së saj të përditshme operative i përgjigjet drejtpërdrejt guvernatorit të Bankës Popullore. DAB-i, sipas nevojës, përgatit raporte dhe informacione të dedikuara për Komitetin e Auditimit dhe Këshillin e Bankës Popullore.

Audituesi kryesor i brendshëm përgatit raport gjashtëmuor dhe vjetor për funksionimin e DAB-it dhe mbi efektet e veprimtarisë së saj, të cilat ia paraqet guvernatorit, Komitetit të Auditimit dhe Këshillit të Bankës Popullore. Këto raporte kanë strukturën e mëposhtme:

- njoftimin për arritjen e qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara në programin vjetor të punës së auditimit,
- njoftimin e ndryshimeve në planin vjetor të auditimit,
- kohën e përdorur për kryerjen e auditimeve,
- njoftimin për auditimet e jashtëzakonshme (të veçanta) të kryera,
- nivelin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna,
- njoftimin për aktivitetet e tjera të kryera,
- njoftimin për punonjësit dhe trajnimin dhe zhvillimin e tyre dhe
- pasqyrat dhe regjistrimet financiare, procedurat kontabël, menaxhimin e rrezikut, sistemin e kontrollit të brendshëm, procesin e menaxhimit, efikasitetin dhe kostot e operacioneve të Bankës Popullore.

Raporti vjetor jep gjithashtu opinionin e përgjithshëm të DAB-it për përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm për proceset / aktivitetet e punës të audituara, si dhe strukturën e rrezeve të përcaktuara nga gjetjet e auditimit, Programi i Sigurimit të Cilësisë dhe Përmirësimit të Performancës, si dhe rezultatet e vlerësimeve të brendshme (mbikëqyrja e vazhdueshme dhe vetëvlerësimet periodike) dhe vlerësimet e jashtme.

Komiteti i Auditimit shqyrton edhe programet vjetore dhe afatmesme të punës së DAB-it, si dhe aktet e tij që rregullojnë punën e DAB-it, para miratimit të tyre nga Këshilli. Audituesi kryesor i brendshëm informon Komitetin e Auditimit dhe Këshillin e Bankës Popullore në rast të ndikimeve në auditimin e brendshëm dhe tregon pasojat e mundshme.